

NEWSLETTER

Maj

**Albsig Pjesëmarrës
në Event-trajnimin
më të Madh në
Shqipëri e Rajon.**

**“Toka është
Shtëpia Jonë”**



INTERVISTË FRYMËZUESE ME
Majlinda Gropa

**Mendo,
Ndrysho, Fito**

**Albsig, mban
Numrin më të Vogël
në Treg për Dëmet Pezull.**

**Raste
Dëmshpërblimi
në Kohë Rekord**

**Albsig Pjesëmarrës
në Panairin e Punës
në Fakultetin Ekonomik.**

**Biznesi i Vogël:
Sigurimet në Albsig
Pasaporta e Jetëgjatësisë në Treg.**

**Kastrati Grup i dhuron Komunitetit Mysliman
Xhamine e Re në Mullet**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.





Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP

Intervistë frymëzuese me Majlinda Gropa

Drejtoreshë Dega Fier Albsig



“Albsigu, Koha e Artë e 30 Viteve Punë në Sigurim”


Ka kapërcyer 30 vite punë në sigurime. Madje i duket e pabesueshme se si ikën vitet që nga dita e parë kur ka filluar e deri më sot. Sigurimet janë fusha më e bukur që ajo ka spikatur që në ditën e parë që kur ka nisur marrëdhëniet e punës. Bëhet fjalë për punonjësen më të kahershme të Albsig, Majlinda Gropa, Drejtoreshë Dega Fier, e cila do të na tregojë rrugëtimin e saj 30 vjeçar në fushën e sigurimeve, ku 18 vite i ka të lidhura me Albsig, si dhe lidhjen e saj me sigurimet që në fillesat e përvojës në këtë fushë.

Kur keni filluar punë në sigurime, a ka qenë shume e vështirë për ty fillimi i kësaj eksperience?

Kam filluar punë në sigurime që në vitin 1992. Ishte eksperiencia e parë e punës që po filloja pas përfundimit të fakultetit. Ishte një eksperiencë e re, sepse të punosh në kompanitë e sigurimeve të asaj kohe, ishte një meritë shumë e madhe për gjithësecilin prej nesh. Unë në fillimet e mia kam patur shumë detyra, kam filluar arkëtare, më pas jam emëruar specialiste finance ku qëndrova për një periudhë goxha të gjatë. Duke parë aftësitë e mia profesionale unë kalova dhe në Departamentin e Shitjeve sepse kisha shumë aftësi në fushën e sigurimeve sidomos për shitjen e produkteve. Për këtë jam kualifikuar në trajnime të ndryshme me trajner shqiptarë dhe të huaj dhe jam licencuar për një gamë të gjerë produktesh në fushën e sigurimeve.

Si ka ndryshuar mendësia e konsumatorëve të zonës që ju përfaqësoni për t'u pajisur me sigurime?

Me një matematikë të thjeshtë unë kam plot 30 vite punë në sigurime. Normal qe ka ndryshuar shumë mendësia e konsumatorëve edhe në zonën që unë përfaqësoj. Nese më parë duhej të këmbëngulje duke sqaruar domosdoshmërinë e produkteve të sigurimeve, sot konsumatorët e kërkojnë vetë produktin që ju duhet në mënyrë vullnetare. Tani produktet vullnetare sidomos në ALBSIG janë kryesorët. Edukata për sigurimet është shtuar edhe në shkolla dhe duket që nga viti në vit dhe konsumatorët po ndërgjegjësohen.



Si nisi rrugëtimi Juaj në Albsig?

Rrugëtimi im në Albsig ka nisur që në Tetor të 2004. Propozimi për të dalë në një kompani tjetër sigurimesh erdhi të unë në momentin e duhur. Pikërisht kur unë isha e plotësuar, jo vetëm nga ana profesionale, por kisha të kopsitur dhe të gatshme database-in e klientëve të mi besnik. Mua më pëlqeu si kompani sepse krijova besim, garanci dhe siguri, si për veten ashtu edhe për klientët e mi.

Sa vite keni që punoni në Albsig dhe si e shikoni të ardhmen e shoqërise për zonën që ju përfaqësoni?

Numëroj plot 18 vite të arta në këtë kompani dhe jam shumë krenare për misionin që mbart dhe për atë që përfaqësoj. Albsig më ka pëlqyer që në momentin e themelimit dhe nga emri goditës dhe kuptimplotë. Po ta gërmëzojmë emrin ALBSIG ne do ta kuptojmë edhe më mirë misionin që fshihet.

A-Tregon autoritetin që më kanë dhënë perfaqësuesit e shoqërisë nga qendra dhe udhëzimet që duhej të ndiqja.

L-Liria e shitjes dhe e ofertave që une jap, liria në përzgjedhjen e stafit.

B-Besimin që përcjell shoqëria në të gjitha statet e saj që nga klientët e deri tek pronarët.

S-Siguria që klienti ka te kompania Albsig gjatë gjithë kohës.

I-Investimin që çdo klient bën te kompania.

G-Garancinë që klienti do të ketë gjithmonë nga Albsig.

Problematikat e punës i ndani me familjarët tuaj dhe si e presin ato këtë qasje?

Marrëdhënia e mirë jo vetëm me drejtuesit e shoqërisë, por dhe me drejtorët e produkteve ka bërë që puna të shkojë shumë mirë. Si çdo punë edhe kjo e jona ka problematikat e saj, por falë marrëdhënieve të mira, problemet janë të zgjidhshme dhe ne nuk mbartim stres për ta dërguar dhe atë në shtëpi. Familja ime tashmë është familjarizuar me natyrën e punës që unë kam dhe jo vetëm, e kupton rëndësinë e sigurimeve duke jua përcjellë dhe të tjerëve atë.

Po vajzën tuaj keni dëshirë ta angazhoni me sigurimet meqë ju keni një jetë që punoni në këtë fushë?

Vajza është e lirë në zgjedhjet e saj. Unë nuk jam imponuese për asgjë, sidomos për profesionin që ajo do të përzgjedhë në të ardhmen. Më vjen mirë që ajo është kërkuese përse i përket punës sime sepse për çdo produkt të ri që se ka dëgjuar më parë nga unë kërkon shpjegime dhe teorikisht ajo i di pothuajse të gjitha produktet. Vajza është e lirë të zgjedhë profesionin që dëshiron, por edhe po të zgjedhë profesionin tim do isha shumë e kënaqur.

Ku e shikoni veten pas 5 vitesh?

Pas 5 vitesh unë veten e shikoj në Albsig, më të fortë, dhe të parën në të gjitha produktet. Kjo jo vetëm për mua dhe zonën që përfaqësoj prej kaq vitesh, por për të gjithë shoqërinë e mendoj që ne do të jemi të parët. Them të parët sepse Albsig është e vetmja kompani sigurimesh që ka bërë edukimin e konsumatorëve për rëndësinë e sigurimeve vullnetare. Është e para kompani që ka sjellë risi në treg përse i përket rëndësisë së sigurimeve vullnetare për gjithësecilin prej nesh.





“Mjeshtëro Biznesin”

**Albsig Pjesëmarrës në
Event-trajnimin më të
Madh në Shqipëri e
Rajon.**

"Mjeshtëro Biznesin", është event-trajnimi i parë më i madh në Shqipëri dhe në rajon kushtuar biznesit, event në të cilin mori pjesë dhe Albsig. Stafi i Albsig ka qenë në një rrugëtim 3-ditor në të cilin morën pjesë 800 pjesëmarrës nga bizneset më të njohura mbarë shqiptare dhe mbi 30 orë trajnim intensiv me skuadrat më të mira në fushat e ndryshme të biznesit.

Albsig ka marrë pjesë në trajnimin e përvitshëm të realizuar nga Vasil Naçi dhe skuadrën e tij. "Mjeshtëro Biznesin" është një program i ideuar për sipërmarrësit, drejtuesit dhe këdo që dashuron biznesin dhe ka pritshmëri dhe standarde individuale shumë të larta. Gjatë tre ditëve të "Mjeshtëro Biznesin", Vasil Naçi dhe skuadra e tij e ekspertëve, janë fokusuar në mënyrën e ndërtimit të kulturës, strategjive, sistemeve dhe burimeve e praktikave më të mira për sukses afatgjatë. Albsig ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë promotore e risive dhe trendeve të momentit.

Zhvillimi dhe trajnimi i punonjësve është procesi i investimit strategjik të kohës, energjisë dhe burimeve në përmirësimin e personelit të kompanisë. Trajnimi paraqet një mundësi reale për të zgjeruar bazën e njohurive të të gjithë punonjësve. Trajnime të tilla do t'i japin punonjësve aftësi të reja, një kuptim më të madh të përgjegjësisë brenda rolit të tyre dhe nga ana tjetër të ndërtojnë vetëbesimin e tyre. Vetëbesimi dhe njohuritë që marrin punonjësit do të përmirësojë performancën e tyre të përgjithshme dhe kjo shkon në të mirë të kompanisë. Punonjësit që janë kompetent dhe në krye të ndryshimit të standardeve të industrisë ndihmojnë kompaninë të mbajë një pozicion udhëheqës dhe të jenë konkurrentë të fortë brenda industrisë.



“Toka Është Shtëpia Jonë”



Toka është shtëpia jonë, është vendi i vetëm ku njerëzit marrin ajrin, ushqimin dhe nevojat e tjera për një jetesë të shëndetshme. Të kujdesemi për të! Është kjo thirrja e brendëshme që e ka secili prej nesh. Mjediisi rreth nesh është një pjesë thelbësore e mbijetesës njerëzore dhe luan një rol thelbësor për një jetesë të shëndetshme, prandaj duhet sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi për njerëzit e sidomos gjeneratat e reja, që ta ruajnë dhe të kujdesen për ambientin.

Kësaj thirrje i është përgjigjur pikërisht në Ditën e Tokës dhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig duke dalë në terren për të pastruar parqet dhe lulishtet e kryeqytetit. “Sot është një ditë shumë kuptimplotë e cila na kujton se sa i rëndësishëm është mjediisi ku

jetojmë. Së bashku me një grup të punonjësve të Albsig vendosëm të japim kontributin dhe një mesazh për të mbajtur pastër një ndër zonat, e cila luan rolin e mushkërisë për kryeqytetin tonë.

“Përgjegjësia sociale në kompaninë tonë do të ketë vëmendje të shtuar edhe me projekte të tjera ku sigurisht pas mbjelljes së pemëve dhe pastrimit të sotëm, aktivitete të tjera do të pasojnë në muajt në vijim po në këtë kuadër”, kështu është shprehur Valbona Dako, Drejtoreshë Marketingu në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig.

Plot 40 punonjës të Albsig të ndarë në dy grupe kanë mundur të pastrojnë parkun pranë Kopshtit Zoologjik në Tiranë. Punonjësit e Albsig të veshur

me uniformat përkatëse, të udhëhequr nga punonjësit e Bashkisë kanë mundur të pastrojnë një zonë prej afro 10 hektarësh duke mbledhur më shumë se 15 ton mbeturina urbane.


Sipas Drejtoreshës së Marketingut, nuk ka mënyrë më të mirë për t'u kthyer në kontakt me natyrën se sa për të dalë në natyrë dhe për të provuar mrekullitë e shumta të saj. "Arsyeja e aktivitetit është rritja e ndërgjegjësimit dhe t'i ftojme qytetarët të eksplorojnë bukuritë e natyrës dhe të mbrojnë mjedisin sa më shumë që të jetë e mundur, e jo vetëm në Ditën e Tokës", theksoi Dako.

Ajo i bën thirrje çdo institucioni që të nisin të parët pastrimin dhe kujdesin për mjedisin, "Bëhuni vullnetarët e parë të cilët pastrojnë mjedisin përreth jo vetëm në Ditën Ndërkombëtare të Tokës. Krijoni grupe vullnetare të ndryshme ose bëhuni pjesë e tyre".

Një mjedis më i pastër sot, do të thotë një mjedis më i shëndetshëm nesër. E ardhmja duhet të jetë e fokusuar në gjelbrim dhe rekreacion në këtë ambient, duke qenë të gjithë të përkushtuar për mbrojtjen e ambientit dhe gjelbrimin e tij.



Bli Online



Dëshmëpërblime në Kohë Rekord

New message



To info@albsig.al

Subject

Mirëmëngjes,

Uroj të jeni mirë!

Më lejoni t'ju falenderoj për përgjigjen në kohë dhe në mënyrë shumë të shpejtë lidhur me rastin tim të dëshmëpërblimit të automjetit.

Pritja që m'u be në ambientet e kompanisë Albsig ishte shumë profesionale dhe trajtimi i rastit tim gjithashtu. Plus i gjithë procesi u krye në një kohë të shpejtë, që nga momenti i vlerësimit të dëmit e deri në marrjen e dëshmëpërblimit.

Kam mbetur shumë e kënaqur sesi u trajtua rasti im dhe kompaninë tuaj do t'ua sugjeroj me shumë kënaqësi të gjithë miqve dhe të njohurve të mi.

Ju falenderoj sërish!

Me respekt,
Aurora Sulçe



Send

Save

Cancel

New message



To bhoxha@albsig.al

Subject Mbyllja e procedurës së dëshmëpërblimit

Përsëndetje Besmir,

Së pari dua t'ju falenderoj për bashkëpunimin duke shprehur konsideratat tona për ju që e trajtuat me profesionalizëm këtë procedurë si dhe kompaninë që ju përfaqësoni me të cilën kemi disa vite bashkëpunimi të frytshëm.

Në vijim të komunikimit po ju dërgoj IBAN-in e shoqërisë KESH sh.a për të bërë të mundur kalimin e vlerës së dëshmëpërblimit të vlerësuar nga ana juaj dhe të pranuar nga ne për dëmin e shkaktuar në automjetin me targe AA*****.

Raiffeisen Bank
APARATI KESH Sha
AL** *****

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me respekt,
Aurel Greca



Send

Save

Cancel



Mendo, Ndrysho, Fito

Është ky trajnimi i dedikuar rritjes dhe zhvillimit profesional realizuar nga Ermal Mamaqi.

Mendoje veten tënde në momentet e tua të fundit të jetës: Çfarë do të të thoshte vetja? Si do të ndiheshe për jetën që ke jetuar? PSE NUK I BËRE REALITET TË GJITHË ËNDRRAT QË PATE?

Ti meriton të jetosh jetën në kuptimin e plotë të saj, dhe kjo nuk do të ndodhë nëse ti nuk punon çdo ditë me veten. Cilat janë gjërat në të cilat duhet të fokusohesh vërtet? Cilat janë besimet kufizuese që po të mbajnë pas? Si mund ta çlirosh potencialin tënd të plotë?

Merr përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe të tjera, në trajnimin që do të ndryshojë jetën tënde: "MENDO, NDRYSHO, FITO". Pyetjeve të mësipërme i kanë dhënë përgjigje një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish në trajnim. Në trajnimin e datës 5 dhe 6 Mars zhvilluar në Tiranë kanë marrë pjesë dhe stafi i Albsig, pjesë e Kastrati Grup. Stafi i Albsig është njohur me teknika dhe informacione që mund të ndihmojnë ata të kenë shëndet më të mirë, financa, marrëdhënie më të mira me veten dhe njerëzit.

Ermal Mamaqi ju bëri thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trajnim, sipas tij TANI është koha që ti të arrish qëllimet dhe të marrësh kontrollin e jetës tënde – MENDO, NDRYSHO, FITO është trajnimi që do ta çojë jetën tënde në një tjetër nivel!

”


Albsig Merr Pjesë në Panairin e Punës në Fakultetin Ekonomik.

Më 28.04.2022 Fakulteti Ekonomik, pjesë e Universitetit të Tiranës, organizoi "Panairin e Punës". Stafi i fakultetit së bashku me studentët mirëpritën shumë prej kompanive më prestigjioze në Tiranë, të cilat përmes prezantimeve, fletushkave e materialeve të tjera promovuese, njoftuan studentët për mundësitë e punës dhe pranuan CV-të e tyre për t'i shqyrtuar për punësim. Pjesë e këtij eventit-trajnimi ishte dhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Grup.

Studentët patën mundësi të informoheshin për shumë mundësi praktike dhe punësimi të ofruara nga Shoqëria Albsig. Albsig ka qenë dhe vazhdon të jetë mbështetës i përhershëm i avancimit dhe ndërtimit të karrierës së studentëve gjatë gjithë rrugëtimit të tyre. Pjesëmarrja në këtë panair synon përfshirjen dhe edukimin e brezave të rinj në sektorin e sigurimeve dhe investimeve.

Falë këtij aktiviteti, studentët u njohën më nga afër me mundësitë e praktikave profesionale dhe të punësimit që Albsig ofron në departamente të ndryshme.


Për punën e sotme, mos apliko nesër!



Kastrati Grup i Dhuron Komunitetit Mysliman Xhaminë e Re në Mullet.

Jo larg qendrës së Tiranës në zonën e Mulletit, kryeqytetit tashmë i është shtuar dhe xhamia më e re. Xhami e cila është dhuratë e sipërmarrësit shqiptar Shefqet Kastrati. Ajo tashmë është cilësuar si kulti fetar i kryeqytetit, më i veçanti në vend dhe jo vetëm. Arkitektuara mahnitëse, projekti i veçantë, punimet e brendshme dhe dizenjimet moderne ndërthurur me ato tradicionale i kanë shtuar jo vetëm zonës, por gjithë vendit një gur në gjerdanin e veprave mahnitëse arkitekturore fetare. Edhe pse është ndër xhamitë më të reja të sapo përruara, ajo duhet konsideruar si vepër arti e cilësive Evropiane. Arkitektura e jashtme dhe e brendshme e ndërthurur dhe me pozicionin gjeografik që foltorja ka, ka bërë që të dalin në pah dhe më shumë veçantitë e saj. Xhamia në Mullet mori emrin e një ndër besimtarëve më të devotshëm dhe më të respektuar që nga koha e komunizmit e deri në ditët e sotme, Z. Jonuz Hajredin Kastratit, babait të presidentit të Grupit

Kastrati, Z. Shefqet Kastrati. Edhe pse në moshë të thyer, Jonuz Kastrati udhëton disa herë drejt Mekës për të qenë gjithnjë e më afër me fenë Islame. Ai ka qenë dhe është gjithmonë pranë njerëzve të komunitetit duke u kujdesur dhe duke krijuar besim tek ata. Trashëguar dhe nga të parët e tij, për Shefqet Kastratin besimi në Zot është një nga pikat e tij më të forta, ndaj dhe zhvillimin e bizneseve të tij, ai gjithmonë e shikon si një mundësi për t'u shërbyer njerëzve, për t'i ndihmuar ata dhe për të krijuar dhe rritur mirëqenie. Ai kurrë nuk ka hequr dorë dhe nga bamirësia, duke iu gjendur pranë kujtdo në ditë të vështira. Kastrati Group është familja e tij e madhe, e cila mban të lidhur rreth vetes mbi 5.000 familje shqiptare. Pikërisht këto virtyte janë zemra e kësaj sipërmarrjeje të suksesshme, e cila në 30 vite është zgjeruar në mënyrë konstante dhe ka krijuar një reputacion të konsoliduar për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.



Albsig, mban Numrin më të Vogël në Treg për Dëmet Pezull.

Numrin më të vogël në treg e mbajnë dëmet pezull në shoqërinë e sigurimeve Albsig. Duke u bazuar në statistikën e AMF në 3-mujorin e parë të këtij viti, Albsig është Shoqëria e Sigurimeve që ka numrin më të vogël të dëmeve pezull në të gjithë tregun pavarësisht vështirësive që has ky treg. Përsa i përket numrit të dëmeve të krahasuara me vitin e kaluar vërehet një ulje shumë e konsiderueshme, konkretisht për periudhën nga 31.03.2021 numri i dëmeve ishte 287 dosje krahasuar me 31.03.2022 që është 166, rezultoi ulje në 121 dosje dhe në vlerë deri në 45.07%.

287
dosje

31.03.2021

166
dosje

31.03.2022

Aktualisht kjo ulje ka ardhur edhe si rrjedhojë e pagimit të dëmeve TPL me Byronë Kosovare përgjatë muajit Mars, proces ky i reflektuar te dëmet e paguara. Tradita vazhdon në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig, dëmet nuk qëndrojnë pezull. Të gjithë të dëmtuarit marrin menjëherë dëmshpërblimet në kohë rekord dhe kundrejt procedurave të duhura.

Këto tregues financiarë reflektohen dhe vërtetohen fare mirë përmes statistikave zyrtare të Autoritetit të Mbykëqyrjes Financiare, në të cilën Albsig radhitet si Shoqëria e Sigurimeve me numrin më të ulët të dëmeve pezull përkthyer kjo dhe në përqindje e krahasuar me të gjithë tregun. Aktualisht Albsig ka vetëm 2.90% të dëmeve.

2.90% të dëmeve

 **ALBSIG**

PJESË E KASTRATI GROUP



Biznesi i Vogël: Sigurimet në Albsig Pasaporta e Jetëgjatësisë në Treg.

Pronari i Picerisë "I Gemelli": Albsig dëmshpërblim në kohë rekord.

Dëmet nga ngjarjet e sigurimit që qytetarët dhe bizneset deri tani janë mësuar t'i kërkojnë vetëm në rrugë gjyqësore janë pakësuar së tepërmi. Edhe pse, sigurimin e pronës, ende nuk e shikojnë si nevojë për financat e çdo familje apo biznesi shqiptar, duke reflektuar kështu kulturën e ulët të sigurimit të saj në vend. Sa herë ndodhin përmbajtje, zjarre, tërmete, pra fatkeqësi natyrore, vëmendja përqëndrohet menjëherë tek mënyra e dëmshpërblimit nëse fatmirësisht do jenë të siguruar, apo tek hartimi i menjëhershëm i projekt ligjit për sigurimin e detyrueshëm të pronës, por që deri më tani nuk është realizuar asgjë konkrete.

Por rasti i dëmit të ndodhur te Piceri "I Gemelli", në Kodrën e Diellit në Tiranë është ndryshe. Është ndër të paktat biznese që ka menduar dhe për rastet e fatkeqësive natyrore dhe jo vetëm duke u siguruar në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Grup.

"Unë sigurimin e biznesit, konkretisht të Picerisë "I Gemelli" e kam bërë vetë në mënyrë vullnetare në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig. Nuk më ka detyruar as banka, askush tjetër përveçse ndërgjegjia ime për të pasur një biznes të shëndoshë, si rrjedhojë u bëra dhe unë pjesë e shoqërive të shëndosha siç është Albsig", u shpreh Olsi Isufaj pronari i Piceri "I Gemelli". Sipas tij siguri i biznesit është një ndër shtyllat kryesore për të pasur një biznes të sigurt. Njëkohësisht jo vetëm kaq, por ai shton se edukatën për sigurimet duhet ta nisi gjithësecili nga vetja që më pas të pasqyrohet dhe tek të tjerët.

Dëmet që nuk e gjunjzuan Picerinë "I Gemelli":

"Fatkeqësitë natyrore dhe jo vetëm janë të pranishme gjithmonë. Rasti i dëmit të ndodhur në picerinë tonë ishte diçka e papritur dhe e paimagjinuar. Dëmi ndodhi në pjesën e brendshme të kuzhinës. Fatmirësisht kishte vetëm dëme materiale, jo dëme në njerëz edhe pse punonjësit e kuzhinës ishin prezent në ngjarje", tregon z. Isufaj në lidhje me dëmin e ndodhur në mjediset e brendshme të picerisë që ai disponon. Edhe pse në raste të tilla paniku të kaplon çdo levizje, duket që për pronarin e picerisë paniku në këtë rast s'ka gjetur vend. "Kam lajmëruar menjëherë Shoqërinë e Sigurimeve Albsig, ku kam marrë përgjigje të menjëherëshme nga stafi i profesionistëve. Grupi i inxhinierëve të Albsig ka ardhur në vendngjarje dhe ka kryer inspektimin e vendit të ngjarjes. Është identifikuar dhe detajuar çdo e dhënë në lidhje me dëmin e ndodhur", tregon z. Isufaj. Ai shton se stafi Albsig i është përgjigjur në mënyrë të menjëherëshme thirrjes për dëmin e ndodhur gjithashtu pas dakortësimit kanë përgatitur menjëherë dosjen për dëmshpërblim." Pasi identifikuan shkakun e dëmit, njëkohësisht dhe dëmet e ndodhura në kuzhinë ku fatmirësisht ishin të pa konsiderueshme, së bashku me inxhinierët u përgatit dosja dhe u dakortësua për dëmshpërblim. Grupi i inxhinierëve të Albsig na komunikoi dy mundësi dëmshpërblimi njëra ishte që të kalojnë të hollat përmes bankës kurse tjetra ishte që ata të sillnin grupin e punës për ta rikthyer kuzhinën në gjëndjen e mëparshme, por ne pranuan të parën. Dhe brenda tre ditëve ne morëm dëmshpërblimin e dëmit të ndodhur", vijon së treguari pronari i picerisë.



Ai është shumë entuziast dhe shumë falenderues ndaj kompanisë pasi sipas tij kanë qenë mënyra e punës së Albsig që ja lehtësoj punën dhe atij për të rinisur aktivitetin e përditshëm. "Për bizneset e vogla siç jam unë është shumë i domosdoshëm siguri. Unë nga përvoja që kam patur jashtë, sepse kam punuar në Evropë dhe jam ndikuar atje sepse një pjesë e mirë e sigurimeve janë me detyrim. Kurse këtu ne kemi kulturë shumë të ulët për sigurimet, që mungesa e kësaj kulture po e çon biznesin e vogël drejt falimentimit", tregon z. Isufaj.





Mungesa e edukimit dhe rëndësia e sigurimit të pronës.

“Në vendin tonë mungon edukimi mbi sigurimet. Nga përvoja ime personale vetëm fal sigurimit që unë kisha për efekt kredie arrita të përfitoja dëmshpërblim të menjëhershëm në kohën e tërmetit të Nëntorit të 2019. Tani që ja di rëndësinë e sigurimit e kam siguruar vullnetarisht apartamentin dhe biznesin familjar që kam një lokal dasmash”, tregon Armend Memiaj pronar i një lokali pranë Kodrës së Diellit në Tiranë. Ai shton se përvojën e dëmshpërblimit nga tërmeti, përfituar nga Albsig e ka cilësuar si një ndër përvojat më të mira në kohët më të vështira. Madje ai këmbëngul dhe te rrethi i tij familjar dhe shoqëror dhe ja sygjeron Albsig-un si kompaninë më të mirë në fushën e sigurimeve. “Unë ua kam sygjerruar miqve dhe familjarëve Albsig-un si kompaninë më të mirë në fushën e sigurimeve. Është e para në dëmshpërblimin e klientëve të saj. Unë jam mirënjohës sepse nuk më kanë penguar asnjë ditë në biznesin tim por më kanë ndihmuar që unë të rimëkëmbem menjëhere”, përfundon Memiaj.

Ndërgjegjësimi për të paguar një sigurim (prone, shtëpi, biznes, etj) është ende në shkallë të ulët në vend dhe vlerësimet tregojnë se minimalisht vetëm 2 banesa janë të siguruara në 100 të tilla. Ky nivel do të ishte edhe më i vogël nëse bankat mos t’i detyronin ata që marrin kredi, që të sigurojnë banesën apo pasurinë e paluajtshme që blejnë përmes kredisë.

Agime Kastrati

(Marketing Manager - Albsig SH.A)

Oferta është e vlefshme deri më 31 Maj 2022.



Bli Sigurimin e Pronës

20% ulje

**Përfito 1,000 lekë kontribut falas në
Fondin e Pensionit Albsig**



☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL